REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**Data:** 16 Mars 2021 | **Nr:** 148

# VENDIM

## PËR CAKTIMIN E VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja "n" dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

**V Ë R E N**

Referuar nenit 94, të Kodit Zgjedhor, jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet për caktimin e Vendin e Numërimit të Votave, sipas përcaktimeve në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 4, paragrafi 4, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr.3, datë 9.02.2021 "Për kriteret e caktimit dhe organizimit te votave", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, cakton me vendim Vendin e Numërimit të Votave të çdo ZAZ-je.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresat nr. 1348-1359 prot., datë 19.02.2021, i është drejtuar Prefektëve të Qarqeve, duke sjellë në vëmendje afatin ligjor për paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të qarkut përkatës, të cilët përmbushin kriteret e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në Vendimin e Komisionit Rregullator nr. 3, datë 9.02.2021 "Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave".

Prefektët e 12 (dymbëdhjetë) qarqeve, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 94, paragrafi 1, të Kodit Zgjedhor, kanë paraqitur në KQZ listën e objekteve brenda territorit të qarkut

përkatës. Për çdo objekt është referuar mjedisi ku mund të caktohet VNV-ja dhe është paraqitur planimetria e tij.

Nga shqyrtimi i të dhënave të objekteve të paraqitura, rezulton se objektet dhe mjediset përkatëse përmbushin kushtet e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe Vendimin e Komisionit Rregullator nr. 3, datë 9.02.2021 "Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave":

- janë salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive;
- plotësojnë kriterin teknik të sipërfaqes bazuar në numrin e QV-ve të ZAZ-së;
- përgjithësisht, janë brenda territorit të ZAZ-ve;
- ofrojnë lehtësi logjistike të transportit rrugor nga QV-të e ZAZ-së;
- ofrojnë kushte për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave;
- kanë sistem të pandërprerë të furnizimit me energji elektrike.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja "n", dhe 2, nenin 93, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në nenet 4 dhe 5, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr.3, datë 9.02.2021, "Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave",

**VENDOSA:**

1. Të caktoj Vendet e Numërimit të Votave, sipas lidhjes bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3(tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

| Qarku | KZAZ | Nr. QV | Objekti i propozuar per VNV | Siperfaqja |
|---|---|---|---|---|
| Shkoder | 01 | 72 QV | Palestra Shkolles "Avdyl Bajraktari" | 650 m2 |
| | | | | |
| | 02 | 109 QV | Pallati Sportit "Qazim Dervishi" | 650 m2 |
| | | | | |
| | 03 | 49 QV | Palestra Shkolles "Arben Broci" | 150 m2 |
| | | | | |
| | 04 | 46 QV | Palestra Shkolles "Azem Hajdari" | 250 m2 |
| | | | | |
| | 05 | 46 QV | Palestra Shkolles "Xheladin Fishta" | 500 m2 |
| | | | | |
| | 06 | 53 QV | Palestra Shkolles Profesionale, Bushat | 300 m2 |
| | | | | |
| | 07 | 20 QV | Pallati Sportit prane Shkolles se mesme "Sabah Sinani" | 759 m2 |
| | | | | |
| | 08 | 16 QV | Palestra e shkolles "Pjeter Arbnori" | 199.5 m2 |
| | | | | |
| Kukes | 09 | 40 QV | Pallati Sportit te Lojerave me dore, B.Curri | 520 m2 |
| | | | | |
| | 10 | 28 QV | Mensa e konviktit "Kosova" | 158.8 m2 |
| | | | | |
| | 11 | 91 QV | Palestra e shkolles "Havzi Nela" | 314 m2 |
| | | | | |
| | | | | |
| Lezhe | 12 | 58 QV | Shkolla e mesme "Hydajet Lezha" | 270 m2 |
| | | | | |
| | 13 | 70 QV | Shkolla 9-vjeçare "Besëlidhja" | 270 m2 |
| | | | | |
| | 14 | 49 QV | Pallati I sportit "Arjana Arapi " | 496 m2 |
| | | | | |
| | 15 | 74 QV | Shkolla e mesme "At' Shtjefën Gjeçovi" | 288 m2 |
| | | | | |
| Diber | 16 | 50 QV | Pallati Sporti Ferid Hysa | 600 m2 |
| | | | | |
| | 17 | 27 QV | Ambient Privat Gjyljano Dedolli | 253 m2 |
| | | | | |
| | 18 | 53 QV | Pallati Kultures, Salla e Teatrit | 331.5 m2 |
| | | | | |
| | 19 | 100 QV | Palestra e shkolles se mesme "Nazmi Rushiti" | 300 m2 |
| | | | | |

| Qarku | KZAZ | Nr. QV | Objekti i propozuar per VNV | Siperfaqja |
|---|---|---|---|---|
| Durres | 20 | 92 QV | Salla e kulturës e Bashkisë Krujë | 300 m2 |
| | | | | |
| | 21 | 108 QV | Pallati i Sportit "Ramazan Njala" | 500 m2 |
| | | | | |
| | 22 | 82 QV | Palestra e shkollës "Marie Kaçulini" | 300 m2 |
| | | | | |
| | 23 | 73 QV | Palestra e shkollës "Leonik Tomeo" | 300 m2 |
| | | | | |
| | 24 | 72 QV | Palestra e shkollës "Hysen Çela" | 234 m2 |
| | | | | |
| | 25 | 54 QV | Palestra e shkollës "16 Shtatori" | 394 m2 |
| | | | | |
| | | | | |
| Tirane | 26 | 44 QV | Shkolla 9-vjeçare Vorë, Palestra | 500 m2 |
| | | | | |
| | 27 | 88 QV | Shkolla 9-vjeçare "Hillary Clinton" | 700 m2 |
| | | | | |
| | 28 | 42 QV | Gjimnazi "Isa Boletini", Palestra | 560 m2 |
| | | | | |
| | 29 | 100 QV | Palestra e shkolles 9-vjeçare, Katund i Ri | 310 m2 |
| | | | | |
| | 30 | 86 QV | Palestra e shkolles 9-vjeçare, "1 Maj" | 500 m2 |
| | | | | |
| | 31 | 57 QV | Palestra e shkolles 9-vjeçare, "Kushtrim i Lirisë" | 200 m2 |
| | | | | |
| | 32 | 87 QV | Palestra, Shkolla "Hasan Tasim" | 440 m2 |
| | | | | |
| | 33 | 52 QV | Palestra, Shkolla mesme "Andon Zako Çajupi" | 350 m2 |
| | | | | |
| | 34 | 72 QV | Palestra e shkollës 9-vjeçare, "Bajram Curri" | 250 m2 |
| | | | | |
| | 35 | 95 QV | Palestra e shkollës 9-vjeçare, "Vasil Shanto" | 500 m2 |
| | | | | |
| | 36 | 71 QV | Palestra e shkollës 9-vjeçare, "Betim Muço" | 200 m2 |
| | | | | |
| | 37 | 82 QV | Palestra e shkollës 9-vjeçare, "Gustav Mayer" | 320 m2 |
| | | | | |
| | 38 | 50 QV | Palestra, Shkolla e Kuqe | 390 m2 |
| | | | | |
| | 39 | 71 QV | Muzeu Historik Kombëtar | 300 m2 |
| | | | | |
| | 40 | 32 QV | Palestra, Shkolla mesme "Qemal Stafa" | 580 m2 |
| | | | | |
| | 41 | 69 QV | Palestra e shkollës 9-vjeçare, "Ahmet Gashi" | 370 m2 |
| | | | | |
| | 42 | 83 QV | Palestra, Shkolla mesme "26 Marsi" | 310 m2 |
| | | | | |
| | 43 | 52 QV | Qendra Kulturore "Haxhi Memolla" | 220 m2 |
| | | | | |

| Qarku | KZAZ | Nr. QV | Objekti i propozuar per VNV | Siperfaqja |
|---|---|---|---|---|
| Elbasan | 44 | 48 QV | Salla kryesore e Pallatit te Kultures | 200 m2 |
| | 45 | 39 QV | Palestra e gjimnazit, Belsh | 250 m2 |
| | 46 | 58 QV | Palestra e shkolles "Aleks Buda" | 200 m2 |
| | 47 | 101 QV | Pallati i Sportit "Tomorr Sinani" | 331 m2 |
| | 48 | 44 QV | Palestra e shkolles Jorgji Dilo" | 755 m2 |
| | 49 | 39 QV | Pallati i Sportit "Tomorr Sinani" | 331 m2 |
| | 50 | 38 QV | Pallati i Sportit "Tomorr Sinani" | 331 m2 |
| | 51 | 49 QV | Pallati i Sportit, Gramsh | 1350 m2 |
| | 52 | 55 QV | Palestra e gjimnazit, "Ibrahim Muça" | 1008 m2 |
| | 53 | 39 QV | Palestra e shkolles "Halit Bërzeshta" | 300 m2 |
| Fier | 54 | 90 QV | Palestra e shkolles "Skender Libohova" | 504m2 |
| | 55 | 65 QV | Holli i Muzeut Historik, Lushnje | 200 m2 |
| | 56 | 67 QV | Qendra Kulturore, Divjake, kati i dyte | 208.6 m2 |
| | 57 | 63 QV | Palestra e shkolles "Petro Sota" | 202.5 m2 |
| | 58 | 62 QV | Palestra e shkolles "Jakov Xoxa" | 350 m2 |
| | 59 | 97 QV | Palestra e shkolles "Janaq Kilica" | 591 m2 |
| | 60 | 48 QV | Salla e konferencave te Pallatit Kultures, kati i dyte Patos | 160 m2 |
| | 61 | 34 QV | Salla e shfaqjeve ne Pallatin e Kultures, Roskovec | 176 m2 |
| | 62 | 52 QV | Palestra e shkolles "Dervish Hekali" | 495 m2 |
| Berat | 63 | 47 QV | Qendra Kulturore | 294m2 |
| | 64 | 65 QV | Qendra kulturore e femijeve "Kristaq Laçka" | 320 m2 |
| | 65 | 74 QV | Qendra kulturore e femijeve "'Margarita Tutulani" | 363 m2 |
| | 66 | 45 QV | Biblioteka "Vehxhi Buharaja" | 760 m2 |
| | 67 | 23 QV | Pallati i Kultures Poliçan | 120 m2 |
| | 68 | 24 QV | Salla e kinemase "Tefik Lepani" | 160 m2 |

| Qarku | KZAZ | Nr. QV | Objekti i propozuar per VNV | Siperfaqja |
|---|---|---|---|---|
| **Korce** | 69 | 106 QV | Pallati i Sportit (Kendi lojerave me dore) | 790 m2 |
| | | | | |
| | 70 | 76 QV | Palestra e Shkolles se Mesme te bashkuar "Dhimitraq Gjata" | 315 m2 |
| | | | | |
| | 71 | 7 QV | Qendra Shendetesore, Pustec | 120 m2 |
| | | | | |
| | 72 | 50 QV | Qendra Kulturore e Femijeve | 300 m2 |
| | | | | |
| | 73 | 55 QV | Shkolla e mesme "Themistokli Germenji" | 200 m2 |
| | | | | |
| | 74 | 109 QV | Pallati i sportit | 800 m2 |
| | | | | |
| | 75 | 29 QV | Biblioteka e qytetit "Skender Luarasi" | 250 m2 |
| | | | | |
| **Gjirokaster** | 76 | 24 QV | Pallati Sportit Permet | 400 m2 |
| | | | | |
| | 77 | 18 QV | Palestra Shkolles "S.Maleshova" | 200 m2 |
| | | | | |
| | 78 | 27 QV | Pallati Kultures Memaliaj | 150 m2 |
| | | | | |
| | 79 | 23 QV | Pallati Kultures Tepelene | 150 m2 |
| | | | | |
| | 80 | 69 QV | Pallati Sportit Gjirokaster | 848 m2 |
| | | | | |
| | 81 | 9 QV | Pallati Kultures Libohove | 210 m2 |
| | | | | |
| | 82 | 37 QV | Shtepia e Kultures Grapsh | 360 m2 |
| | | | | |
| **Vlore** | 83 | 66 QV | Palestra e shkolles 9-vjeçare "Ismail Qemali" | 456 m2 |
| | | | | |
| | 84 | 53 QV | Pallati Kultures "Laberia" | 250 m2 |
| | | | | |
| | 85 | 52 QV | Palestra e shkolles "Ali Demi" | 540 m2 |
| | | | | |
| | 86 | 54 QV | Pallati Sportit "Flamurtari" | 1600 m2 |
| | | | | |
| | 87 | 42 QV | Palestra shkolles 9 vjecare "Eqerem Beqiri", Kote | 560 m2 |
| | | | | |
| | 88 | 35 QV | Godina e fushes se Sportit, Palestra | 184 m2 |
| | | | | |
| | 89 | 23 QV | Kinoteatri i Qytetit Delvine | 220 m2 |
| | | | | |
| | 90 | 53 QV | Palestra e shkolles mesme "Antoni Athanas" | 276 m2 |
| | | | | |
| | 91 | 50 QV | Qendra Kulturore "Katina Papa", Livadhja | 400 m2 |
| | | | | |
| | 92 | 14 QV | Palestra e shkolles mesme "Bido Sejko" | 350 m2 |
| | | | | |